



KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

PROCES VERBAL

Mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejës për muajin Qershor 2026

Data 29.06.2026 ora 14:00.

Mbledhja zhvillohet në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat.

Rendi i dites:

- 1.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes datë 28.05.2026 dhe informacion për VKB-të e marra në këtë mbledhje.
- 2.Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Maj 2026.
- 3.Projekt vendim për miratimin e projektit parë të PBA 2027-2029 për Bashkinë Vau Dejës.
- 4.Projekt vendim për dhënien në përdorim me afat deri në 10 (dhjetë) vjet sipërfaqen pyjore prej 0.3428 ha “Për agropylltari në ekonominë pyjore Drin Gjader Kirë”
- 5.Projekt vendim për një ndryshim dhe shtesë në Vkb nr.70 datë 28.09.2023 “Për dhënie në përdorim me afat 10 vjeçar të sipërfaqes pyjore prej 33.954 ha, për park fotovoltaiq,(stacionet,bazamentet dhe objektet përkatëse etj) në ekonominë pyjore Drin Gjader Kirë”.
- 6.Projekt vendim për miratimin në parim, për dhënien në përdorim me anë të konkurrimit me afat deri në 10 vjet, të sipërfaqes prej 0.43 ha, pasuria nr.92 Zk nr.2644 e llojit “Shkëmbore”(Pa fryt) fshati Melgushë Nj.A Bushat, Bashkia Vau Dejës.Fusha e përdorimit të pronës “Për veprimtari në fushen e blegtorisë”.
- 7.Projekt vendim për dhënie pelqimi në parim për dhënien në përdorim me anë të konkurrimit me afat deri në 10 vjet, të sipërfaqes prej 0.09 ha, pjesë e pasurisë nr.546/4 Zk nr.3506 e llojit “Pa fryt” fshati Stajkë Nj.A Bushat, Bashkia Vau Dejës.Fusha e përdorimit të pronës “Për veprimtari në fushen e blegtorisë dhe agropërpunimit”
- 8.Raporti i Monitorimit të Bashkisë Vau Dejës për periudhën janar-prill të vitit 2026 dhe Raporti i Vetëvlerësimit Financiar të Bashkisë Vau Dejës për periudhën janar-prill të vitit 2026.
- 9.Të ndryshme.

Grupe interesi nuk kishte prezent.Votimet do bëhen të hapura.

Mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejes u zhvillua me datë 29.06.2026 ora 14.00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat. Fillimisht u bë apeli i



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

këshilltarëve që ishin prezent në sallë, nga ana e sekretarit të Këshillit Bashkiak, Z.Ardian Çelepja. Të pranishëm në sallë ishin 19 këshilltarë, (Ervis Shimaj, Frano Prenga, Franga Kola, Elton Frashnaj, Majlinda Ndreca, Ornela Lleshi, Besmir Kapaj, Kastriot Shkjau, Edona Molla, Albina Livadhi, Mark Bisha, Roberto Trushi, Meliha Zyberaj, Neki Kapllanaj, Arsen Mehmeti, Vjollcë Zagani, Martin Mardoda, Mirela Vasija, Ermir Tahiri), korum i mjaftueshëm dhe i nevojshëm për të zhvilluar mbledhjen e këshillit.

Fjalën për të filluar mbledhjen e mori Z. Ervis Shimaj - kryetar i këshillit bashkiak i cili lexoi rendin e dites. Pyeten këshilltarët nëse ishin dakort me propozimin. Këshilltarët shprehen dakortësi. Hidhet në votim rendi i ditës: **Miratohet me 19 vota Pro, zero vota kundër, zero vota abstenim.** Këshilltarët që votuan pro: (Ervis Shimaj, Frano Prenga, Franga Kola, Elton Frashnaj, Majlinda Ndreca, Ornela Lleshi, Besmir Kapaj, Kastriot Shkjau, Edona Molla, Albina Livadhi, Mark Bisha, Roberto Trushi, Meliha Zyberaj, Neki Kapllanaj, Arsen Mehmeti, Vjollcë Zagani, Martin Mardoda, Mirela Vasija, Ermir Tahiri)

Z. Ervis Shimaj lexon piken e parë të rendit të ditës:

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes datë 28.05.2026 si dhe informacion për VKB-të e marra në këtë mbledhje.

U pyeten këshilltarët nëse ishin dakort me procesverbalin e mbledhjes së datës 28.05.2026 nga Z. Ervis Shimaj. Këshilltarët nuk kishin pyetje dhe të gjithë shprehen dakortësi për miratimin e tij. Këshilltarët që votuan pro, (Ervis Shimaj, Frano Prenga, Franga Kola, Elton Frashnaj, Majlinda Ndreca, Ornela Lleshi, Besmir Kapaj, Kastriot Shkjau, Edona Molla, Albina Livadhi, Mark Bisha, Roberto Trushi, Meliha Zyberaj, Neki Kapllanaj, Arsen Mehmeti, Vjollcë Zagani, Martin Mardoda, Mirela Vasija, Ermir Tahiri).

Z. Ervis Shimaj lexon piken 2 të rendit të ditës:

Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Maj 2026.

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Z. Nikolin Leka- perfaqesues i zyres se ndihmes ekonomike, i cili relaton lidhur me projekt vendimin e paraqitur. Ai shprehet se propozojmë të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin Maj familje 121, me 395,089 lekë, me 5.98% e fondit total. Në total për Bashkinë Vau Dejës, për Muajin Maj 2026 janë shpallur fitues, 860 familje, me fond 6,647,397 leke, nga ku 6% e këtij fondi është 398,843 lekë.

Z. Ervis Shimaj pyet këshilltarët nëse kanë diskutime apo pyetje. Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime. Z. Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 19 vota Pro, zero vota kundra, zero vota abstenim.** Këshilltarët që votuan pro piken e 2 të rendit të ditës: (Ervis Shimaj, Frano Prenga, Franga Kola, Elton Frashnaj, Majlinda Ndreca, Ornela Lleshi, Besmir Kapaj, Kastriot Shkjau, Edona Molla, Albina Livadhi, Mark Bisha, Roberto Trushi, Meliha Zyberaj, Neki Kapllanaj, Arsen Mehmeti, Vjollcë Zagani, Martin Mardoda, Mirela Vasija, Ermir Tahiri).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Në këtë moment largohet këshilltari Z.Neki Kapllanaj për arsye shëndetësore, korumi i këshilltarëve mbetet 18 këshilltarë present, korum i mjaftueshëm për zhvillimin e mbledhjes.

Z.Ervis Shimaj lexon piken 3 të rendit të ditës:

Projekt vendim për miratimin e projektit parë të PBA 2027-2029 për Bashkinë Vau Dejës.

Z.Ervis Shimaj i jep fjalën Znj.Armena Zagani-pergjegjese e zyres financë buxhetit, e cila relatton dhe shprehet se jemi në fazen e parë të pregaditjes së PBA 2027-2029 dhe për këtë qëllim është realizuar edhe konsultim me publikun nga ana e Këshillit Bashkiak dhe do te merren në konsideratë kërkesat dhe propozimet që janë bërë gjatë konsultimit.

Të ardhurat e veta të Bashkisë te kategorizuar sipas llojit te te ardhurave, për periudhen 2027-2029, parashikohen ne vlerat si me poshte:

ne (mijaneke)

Vitet	2027	2028	2029
Ardhurat e veta totale	177,610	178,064	179,864
Ardhura nga taksat vendore	48,592	50,198	48,765
Ardhura nga taksat e ndara	31,284	35,775	33,224
Ardhura nga tarifrat vendore	48,268	58,600	48,381
Ardhura te tjera	49,465	33,490	49,493

Buxheti total për periudhen 2027-2029 për Bashkinë Vau Dejës:

Tabela 6: Buxheti total për periudhën 2027-2029

Nr	Vitet	2027	2028	2028
1	Transferta e Pakushtëzuar	416,143	430,981	445,173
2	Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale	160,671	160,671	162,278
3	Transferta e Kushtëzuar	413,403	413,403	416,403
4	Të Ardhurat	177,610	178,064	179,864
TOTALI		1,167,826	1,183,118	1,203,717

Nuk parashikohet rritje e taksave dhe tarifave vendore dhe per rrjedhojë edhe të ardhurat e Bashkisë në periudhen 2027-2029 do kenë një rritje të lehtë.



Z.Ervis Shimaj pyet këshilltarët nëse kanë diskutime apo pyetje. Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime. Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 18 vota Pro, zero vota kundra, zero vota abstenim.** Këshilltarët që votuan pro piken e 3 të rendit të ditës: ,(Ervis Shimaj, Frano Prenga, Franga Kola, Elton Frashnaj, Majlinda Ndreca, Ornela Lleshi, Besmir Kapaj, Kastriot Shkjau, Edona Molla, Albina Livadhi, Mark Bisha, Roberto Trushi, Meliha Zyberaj, Arsen Mehmeti, Vjollcë Zagani, Martin Mardoda, Mirela Vasija, Ermir Tahiri).

Në këtë moment largohet nga mbledhja këshilltari Z.Robert Trushi korumi i këshilltarëve mbetet 17 këshilltarë present, korum i mjaftueshëm për zhvillimin e mbledhjes.

Z.Ervis Shimaj lexon piken 4 të rendit të ditës:

Projekt vendim për dhënien në përdorim me afat deri në 10 (dhjetë) vjet sipërfaqen pyjore prej 0.3428 ha “Për agropylltari në ekonominë pyjore Drin Gjader Kirë”

Z.Ervis Shimaj i jep fjalën Z.Mark Suli-inxhinjer specialist prane zyres pyjeve i cili relaton për projekt vendimin dhe spjegon se sipërfaqja e marrë në studim pas miratimit në Këshillin Bashkiak do të nështrohet procedurës së konkurimit publik sipas legjislacionit në fuqi. Sipërfaqja që planifikohet të jepet në përdorim është 0.3428 ha. Afati i dhenies me qira do të jetë deri në 10(dhjetë) vjet. Vlera totale e pagesës/vit sipas raportit teknik-ekonomik, do të jetë 3428 lekë në vit (tre mijë e katerqind e njezet e tetë) lekë.

Z.Ervis Shimaj pyet këshilltarët nëse kanë diskutime apo pyetje. Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime. Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 17 vota Pro, zero vota kundra, zero vota abstenim.** Këshilltarët që votuan pro piken e 4 të rendit të ditës: ,(Ervis Shimaj, Frano Prenga, Franga Kola, Elton Frashnaj, Majlinda Ndreca, Ornela Lleshi, Besmir Kapaj, Kastriot Shkjau, Edona Molla, Albina Livadhi, Mark Bisha, Meliha Zyberaj, Arsen Mehmeti, Vjollcë Zagani, Martin Mardoda, Mirela Vasija, Ermir Tahiri).

Z.Ervis Shimaj lexon piken 5 të rendit të ditës:

Projekt vendim për një ndryshim dhe shtesë në Vkb nr.70 datë 28.09.2023 “Për dhënie në përdorim me afat 10 vjeçar të sipërfaqes pyjore prej 33.954 ha, për park fotovoltaiq,(stacionet,bazamentet dhe objektet përkatëse etj) në ekonominë pyjore Drin Gjader Kir”.

Z.Ervis Shimaj i jep fjalën Z.Mark Suli-inxhinjer specialist prane zyres pyjeve i cili relaton për projekt vendimin dhe spjegon se Vkb nr.70 datë 28.09.2023 po shqyrtohet edhe një here nga Këshilli Bashkiak bashkëngjitur certifikatat e pronësisë me Nr. Pasurie 844, Zk.2236 referuar këtij projekt-vendimi. Pas plotësimit të dokumentacionit me praktikën e nevojshme ligjore pranë Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, konkretisht Vendim Nr.25. datë 13.10.2025 "Për miratimin e kërkesës për autorizim për përdorim burimi ujqor për ndërtimin, rindërtimin, apo shembjen për mbrojtjen e brigjeve, mureve, pritave e veprave të tjera në brigje, me vendndodhje



lumi Drin, Bashkia Vau Dejës të Subjektit Bashkia Vau Dejës" Autorizim Nr. serial 000013 "Për veprimtari të tjera në brigje dhe në shtratin e burimit ujorë" Nr. 362 prot., 15. 10.2025, do ngarkohet Drejtoria Ligjore, PP dhe Aseteve që pas miratimit në Këshill Bashkiak, të vijojë me procedurat e konkurrimit publik për dhënie me qira, duke përcaktuar si kusht që subjekti fitues, duhet të përfundojë ndërtimin e argjinaturës sipas vlerësimit të Baseneve Ujore, e më pas të vijojë me zhvillimin e objektit të qiradhënies.

Z.Ervis Shimaj pyet këshilltarët nëse kanë diskutime apo pyetje.Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:**Miratohet me 17 vota Pro, zero vota kundra, zero vota abstenim.**Këshilltarët që votuan pro piken e 5 të rendit të ditës: ,(Ervis Shimaj, Frano Prenga,Franga Kola, Elton Frashnaj,Majlinda Ndreca,Ornela Lleshi,Besmir Kapaj,Kastriot Shkjau,Edona Molla,Albina Livadhi,Mark Bisha,Meliha Zyberaj,Arsen Mehmeti,Vjollcë Zagani,Martin Mardoda,Mirela Vasija,Ermir Tahiri).

Z.Ervis Shimaj lexon piken 6 të rendit të ditës:

Projekt vendim për miratimin në parim, për dhënien në përdorim me anë të konkurrimit me afat deri në 10 vjet, të sipërfaqes prej 0,43 ha, pasuria nr.92 Zk nr.2644 e llojit "Shkëmbore"(Pa fryt) fshati Melgushë Nj.A Bushat, Bashkia Vau Dejës.Fusha e përdorimit të pronës "Për veprimtari në fushen e blegtorisë".

Z.Ervis Shimaj i jep fjalën Z.Ndoc Baqli- përgjegjës i zyrës aseteve i cili relaton për projekt vendimin dhe spjegon se propozohet dhënie në përdorim sipërfaqen prej 0.43 ha e llojit "pa fryt" për veprimtari në fushen e blegtorisë. Pas miratimit nga K.B dhe konfirmimit ligjor nga Institucioni Prefektit, do i nënshtrohen procedurat e konkurrimit publik.Impakti pozitiv është se sjell rritjen e të ardhurave të Bashkisë të cilat përkthehen në investime të shtuara si dhe sjell zhvillim ekonomik për banorët e Bashkisë Vau Dejës.

Z.Ervis Shimaj pyet këshilltarët nëse kanë diskutime apo pyetje.Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:**Miratohet me 17 vota Pro, zero vota kundra, zero vota abstenim.**Këshilltarët që votuan pro piken e 6 të rendit të ditës: ,(Ervis Shimaj, Frano Prenga,Franga Kola, Elton Frashnaj,Majlinda Ndreca,Ornela Lleshi,Besmir Kapaj,Kastriot Shkjau,Edona Molla,Albina Livadhi,Mark Bisha,Meliha Zyberaj,Arsen Mehmeti,Vjollcë Zagani,Martin Mardoda,Mirela Vasija,Ermir Tahiri).

Z.Ervis Shimaj lexon piken 7 të rendit të ditës:

Projekt vendim për dhënie pelqimi në parim për dhënien në përdorim me anë të konkurrimit me afat deri në 10 vjet, të sipërfaqes prej 0.09 ha, pjesë e pasurisë nr.546/4 Zk nr.3506 e llojit "Pa fryt" fshati Stajkë Nj.A Bushat, Bashkia Vau Dejës.Fusha e përdorimit të pronës "Për veprimtari në fushen e blegtorisë dhe agropërpunimit"



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Z.Ervis Shimaj i jep fjalën Z.Ndoc Baqli- përgjegjës i zyres aseteve i cili relaton për projekt vendimin dhe spjeron se propozohet dhënie pelqimi në parim për dhënie në përdorim me anë të konkurrimit me afat deri në 10 vjet, të sipërfaqes prej 0.09 ha, pjesë e pasurisë nr.546/4 Zk nr.3506 e llojit "Pa fryt" fshati Stajkë Nj.A Bushat, Bashkia Vau Dejës.Fusha e përdorimit të pronës "Për veprimtari në fushen e blegtorisë dhe agropërpunimit".Kjo sipërfaqe është e certifikuar në emër të Bashkisë Vau Dejës.

Impakti pozitiv është se sjell rritjen e të ardhurave të Bashkisë të cilat përkthehen në investime të shtuara si dhe sjell zhvillim ekonomik për banorët e Bashkisë Vau Dejës.

Z.Ervis Shimaj pyet këshilltarët nëse kanë diskutime apo pyetje.Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:**Miratohet me 17 vota Pro, zero vota kundra, zero vota abstenim.**Këshilltarët që votuan pro piken e 7 të rendit të ditës: (Ervis Shimaj, Frano Prenga,Franga Kola, Elton Frashnaj,Majlinda Ndreca,Ornela Lleshi,Besmir Kapaj,Kastriot Shkjau,Edona Molla,Albina Livadhi,Mark Bisha,Meliha Zyberaj,Arsen Mehmeti,Vjollcë Zagani,Martin Mardoda,Mirela Vasija,Ermir Tahiri).

Z.Ervis Shimaj lexon piken 8 të rendit të ditës:

Raporti i Monitorimit të Bashkisë Vau Dejës për periudhën janar-prill të vitit 2026 dhe Raporti i Vetëvlerësimit Financiar të Bashkisë Vau Dejës për periudhën janar-prill të vitit 2026.

Z.Ervis Shimaj i jep fjalën Znj.Armena Zagani-pergjegjese e zyres financë buxhetit, e cila shprehet se objektivat e përcaktuar për tu realizuar me faktiken, ka nje rritje per kete 4/mujor, ne krahasim me 4-m e vitit 2025 ne masen afro 25%, ku ndikimi ne rritje ka ardhur si rezultat i rritjes se se te ardhurave te tjera nga grantet e nivelit te qeverisjes vendore, si arketimeve te tarifave vendore, dhe ardhurat nga kontratat e qerave etj.

Shpenzimet e planifikuara buxhetit të Bashkisë Vau Dejës për 4-mujorin I të vitit 2026, nga transfertat e pakushtezuar, transfertat e pakushtezuar sektoriale, fondet e veta, duke përfshirë transfertën e pakushtezuar, transfertën sektoriale, të ardhurat e bashkisë, investimet me të ardhura jashtë limitit dhe fondet e trashëguara të vitit paraardhës, arritën në 312,064 mijë lekë me një nivel realizimi prej 16.14% kundrejt buxhetit total të bashkisë të planifikuara dhe relizuara për vitin 2026. Peshën më të madhe të realizimit në përqindje e zenë pagat dhe sigurime në masen 48%, pastaj transferimet në masen 28%, investimet në masën 17%.dhe se fundmi shpenzimet operative me 7%. Realizimi i shpenzime për të gjitha programet, për 4-mujorin I të vitit 2026 i keni të evidencuara ne raportin e monitorimit me te cilin jeni të pajisur.

Gjendja ekonomiko financiare e bashkisë është e kënaqshme dhe në përmirësim nga viti në vit.
Pika 9 Të ndryshme: Z. Ervis Shimaj fton këshilltarët për pyetje apo diskutime rreth problematikave të hasura meqenëse është i pranishëm Zv-Kryetari Bashkisë Z.Ervis Molla.Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime te kjo pikë e rendit të ditës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Kryetari Këshillit e deklaroi të mbyllur mbledhjen e datës 29.06.2026.

Mbajtësi i Protokollit

Sekretari Këshillit

Ardian CELEPIJA



Këshilltarët:

1. Ervis Shimanj
2. Melike Zhebe
3. Enxheta Fala
4. Anxhela Frenga
5. Ornella Lleshi
6. Hajlinda Noka
7. Arsen Mehmet
8. Elton Froshaj
9. Kastriot Shkijon
10. Evmir Tohir
11. Besmir Kqiq
12. Mirela Vasija
13. Eolona Molla
14. Vjollë Zogoni
15. Allina Livoahi

16. Martin Karoloda
17. Royerto Trushi
18. Welca Kumbon
19. Mark Bishe
- 20.
- 21.
- 22.
- 23.
- 24.
- 25.
- 26.
- 27.
- 28.
- 29.
- 30.
- 31.